



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

REZULTATET FILLESTARE TË POLITIKËS ARSIMORE DHE KULTURORE TË QEVERISË SË VLORËS

Nevila Mehmeti*, Ndriçm Mehmeti**

*Kolegji “Turgut Ozal”

**Departamenti i Edukimit, Albanian University

Adresë kontakti: nevilamehmeti@yahoo.com

Përmbledhje

Studimi sjell në vëmendje një nga çështjet kryesore me të cilat u përball qeveria e përkohshme e Isamil Qemalit menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Duhet thënë që në fillim se shqiptarët e kishin të ndaluar përdorimin e gjuhës shqipe nën sundimin e Perandorisë Osmane e për pasojë, shkollat në gjuhën shqipe mundonin tërësisht. Ishte kjo sfida më e madhe për qeverinë: ngritja e arsimit kombëtar shqiptar. Krahas saj, mungonin mësuesit, tekstet shkollore, materialet didaktike, shkollat për përgatitjen e mësuesve etj. Të gjitha këto pengesa u morën përsipër të kapërceheshin përmes vullnetit të ministrit të parë të arsimit të shtetit shqiptar Luigj Gurakuqi dhe falë kurajës e mbështetjes së popullsisë, që edhe pse në gjendje të vështirë ekonomike e sociale, bëri përpjekje të mëdha për të lëvruar arsimin kombëtar.

Fjalë çelës: arsim, qeveri e përkohshme, arsim kombëtar, shkollë.

INITIAL RESULTS OF EDUCATIONAL AND CULTURAL POLICY OF THE GOVERNMENT OF VLORA

Abstract

The study recalls one of the main issues faced by the interim government of Ismail Kemal, immediately after the declaration of Independence of Albania. It must be said at the outset that the Albanians were forbidden the use of the Albanian language, mother Ottoman Empire and consequently, Albanian-language schools thoroughly vexed. The biggest challenge for the government was the rise of the Albanian national education especially considering missing teachers, textbooks, teaching materials, teacher training schools etc. All these obstacles were undertaken to overcome by the will of the first minister of education of the Albanian state Luigj Gurakuqi and thanks to the courage of the support of the population, although distressed economic, social, and made great efforts to deliver national education.

Keywords: Education, interim government, national education, school.

HYRJE

Në fillim të punës së saj, ligjërimi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare padyshim që është një prej arritjeve të mëdha të qeverisë së Qemalit. Në pikëpamje administrative, të komunikimit, përkthimit, shtypjes së librave etj., shqipja sillte një seri avantazhesh, krahasimisht me gjuhët e tjera. Në pikëpamje të identitetit kombëtar, ishte një tjetër qasje e fortë drejt nacionalizmit shqiptar të ushqyer dhe mbështetur pikërisht mbi gjuhën amtare. Nëse e analizojmë rezultatet e punës së qeverisë jetëshkurtër të Vlorës, në drejtim të arsimit, ajo karakterizohet nga dy faza: faza e parë që përkon me periudhën 28 nëntor 1912 deri në fund të gushtit 1913 dhe faza e dytë, shtator 1913 deri në fund të janarit 1914. Në periudhën e parë, qeveria dukej në pamje të parë, se ishte e mpirë dhe apatike. Kjo gjendje nuk ishte aspak mungesë vullneti, dëshire apo paaftësie. E gjendur në kondita të pafavorshme kombëtare dhe ndërkombëtare, vëmendja më e madhe e punës së kabinetit qeveritar ishte e përqendruar në dy drejtime: sigurimi i tërësisë territoriale të vendit dhe i njohjes nga fuqitë ndërkombëtare. Në fund të vitit 1912 dhe deri në mesin e vitit 1913, I. Qemali ndërmoi disa udhëtimet diplomatike në Evropë për të ndikuar sadopak në zgjidhjen e çështjes shqiptare. Në këto udhëtime ai shoqërohej gjithmonë nga djemtë e tij dhe ministrat e kabinetit, ndër të cilët shquhej gjithnjë prania e ministrit të arsimit L. Gurakuqi. Rrjedhshmëria e të folurit, njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësia e interpretimit të çështjeve të diplomacisë ndërkombëtare e bënin shumë të nevojshme praninë e ministrit të arsimit në krah të kryeministrit. Kështu që është e kuptueshme që në punët e përditshme të qeverisë disa gjëra do të mbeteshin të porealizuara. Në një vend ku sundonte analfabetizmi, mungonin institucionet e vërteta kombëtare arsimore, qeveria mund të themi se ia doli të bëjë shumë më tepër sesa pritej në pozitë e saj. *“Në vitin shkollor 1913-1914 u hapën dhe zhvilluan mësim 64 shkolla shqipe, shumica në fshatra”*. Hapja e këtyre shkollave me siguri që krijoi një impakt të mirë në të gjithë vendin. Qeveria, në kushtet në të vështira që po kalonte, ia doli të kujdesej për nënshtetasit e vet. Ajo vazhdonte ta konsideronte si detyrë themelore të saj zhvillimin e arsimit kombëtar përmes hapjes të sa më shumë shkollave. Jo vetëm hapja e shkollave, por edhe vendet ku ajo i hapte e tregonin më së miri një plan paraprak të mirë menduar. Në parim, zonat rurale ishin (dhe vazhdojnë ende të jenë) pikat e dobëta të një arsimit të barabartë e cilësor. Në atë kohë më shumë flitej për të hapur një shkollë që do të ishte jo vetëm vatër e dijes, por një lloj ngushëllimi në jetën e varfër sociale të fshatit dhe qytetit. *“Kush hap një mësonjëtorë, mbyll dyert e një burgu, dhe ne që kemi lumturin të hapim këtë shkollë, me të vërtetë po bëhemi shkas që të mbyllim një burg.”* Duke u nisur nga faktori social, qeveria kishte vendosur pikërisht që në krye të herës, që hapja e shkollave Normale, të mbulonte të gjitha zonat: në Shqipërinë e Mesme (Elbasani), në jug Berati dhe në Veri si një projekt i fillimit ishte Shkodra ose Dibra. Sigurisht që me kalimin e kohës këto do të shtoheshin, në varësi të kushteve dhe fondeve që do të siguronte qeveria. Në qytetin e Shkodrës, ndonëse ishte në një gjendje lufte për shkak të rrethimit nga forcat malazeze, *“Komisioni i Arsimor i Bashkisë i kryesuar nga kadi i Shkodrës në atë kohë hapi tri shkolla: Shkolla Popullore me drejtor Gaspër Mikelin, e Rusit me drejtor Molla Medo Sukniqi dhe e Parrucës me drejtor Hafiz Abaz Golemi.”* Duke qenë se ky qytet, ishte jashtë pushtetit të qeverisë së Vlorës, organizimin e arsimit e kishin marrë në dorë autoritetet lokale. U krijua një Komitet Arsimor, në përbërjen e të cilit ishin *“At Gjergj Fishta, Hafiz Abaz Golemi, Gaspër Mikeli, Mustafa Kruja etj.”* Për më tutje u mendua që të ngrihej një shkollë normale që do të mbulonte nevojat e Shkodrës dhe rrethinave të saj. Ç’është e vërteta, në atë kohë kishte nevoja të mëdha për mësues të shkollave fillore, kështu që shkollat Normale duhet t’u përgjigjeshin me të njëjtin ritëm këtyre kërkesave. Përpos këtyre iniciativave, edhe qeveria mori masat e saj. Për shtimin e sa më shumë nxënësve që përgatiteshin për mësues të shkollave të ulëta, *“u rihap shkolla Normale*

Elbasanit me drejtor A. Xhuvanin dhe u hap një e re në Berat me drejtor S. Gjukën.” Salih Gjuka në janar 1913 filloi njëkohësisht nga puna edhe si drejtor i arsimit për qarkun e Beratit. Në fillimet e punës së tij, ai hapi aty shkollën Normale të përkohshme, ku do të përgatiteshin mësuesit e parë dhe do të kualifikoheshin mjaft të tjerë. Arsimi ishte tashmë një nga çështjet më themelore të shpallura nga qeveria dhe të gjithë patriotët kërkonin t’i përgjigjeshin me të njëjtën devotshmëri. Ministria e udhëhequr nga Gurakuqi, nga njëra anë përpiqej në hartimin e një vizioni dhe strategjie afatgjatë në këtë fushë, dhe nga ana tjetër nuk harronte të merrej me çdo probleme që përballëshin nxënësit dhe mësuesit e tyre. Natyrisht që të gjitha nuk mund të zgjidheshin njëherësh, por përkushtimi për të qenë sa më i pranishëm në këto halle e vetë kreut të ministrisë së arsimit, nuk mungonte. Në vijimësi të punës së tij, Gurakuqi interesohej personalisht për gjendjen ekonomike, mundësitë për nxënësit shqiptarë që niseshin për studime jashtë vendit, si dhe për shkollat ku ata studionin. *“Në vaporin e Lloyd-it që vinte prej Durrësi, u nisën sot për në Stamboll tetë djem, të cilët janë nxënës në Robert College. Z. Gurakuqi u a lehtësoj rrugën djemve me më shumë mënyra lëndore e morale.”* Tekstet shkollore ishin një prej sfidave më të mëdha të shkollës së re shqiptare. Përpjekjet për hartimin e teksteve shqip më së shumti ishin kryer jashtë vendit.

Tekstet hartoheshin, shtypeshin e botoheshin në përputhje me qëllimet dhe objektivat e autorit. Kjo ishte e justifikueshme, pasi e kemi thënë edhe më parë, në Shqipëri përdoreheshin shumë abetare në disa dialekte, kështu që edhe tekstet mundoheshin t’i përshtateshin këtyre dy standardeve. Tanimë kjo punë duhej bërë e përqendruar, nën mbikëqyrje e një autoriteti zyrtar shtetëror, duke iu përmbajtur disa standardeve të përcaktuara në pikëpamje shkencore-didaktike. Për këtë qëllim do të shërbente “Akademia Kombëtare”. Deri në formimin e plotë të saj, Ministri i Arsimit, u investua vetë për vendosjen e disa rregullave e standardeve për të kapërcyer sa më shpejt situatën. Si një ndër hartuesit e teksteve për shkollat shqipe më parë, Gurakuqi, pati një vizion modern të hartimit, mënyrës së shtypjes së tyre, shpërblimin e autorëve të teksteve apo përkthyesve të tyre në gjuhën shqip. Madje u mendua edhe sesi do të mbroheshin të drejtat e autorëve të teksteve shkollore. Për të përballuar sa më shpejt fillimin e shkollës, ministria e arsimit mendoi që të fillohej pa humbur kohë me hartimin dhe botimin e teksteve shkollore më të domosdoshme. Për realizmin e këtij objekti, iu bë thirrje të gjithë veprimtarëve në fushën e arsimit, mësues të shkollave dhe autorë të mëparshëm të teksteve të jepnin kontributin e tyre. Po kështu, ishin të mirëpritura edhe tekstet e përkthyer dhe të përshtatura për shkollën fillore. *“U vendos të përgatiten për shtyp sa më shpejt librat e nevojshëm për të përkthyer dy-tre libra nga gjuhët e huaja, përcaktohet masa e shpërblimit prej 70 frangësh për çdo fashikull tipografie.”* Për të patur të drejtën mbi këto botime të autorit, ministria e arsimit, angazhohej se do t’i mbronte me të njëjtat standarde, që kishte bota e qytetëruar. *“I lihej për dy-tre vjet e drejta e ribotimit Ministrisë së Arsimit dhe pastaj kjo e drejtë i kalonte autorit.”* Thirrjes për të kontribuar në këtë drejtim iu përgjigjën emra shumë të njohur në fushën e arsimit kombëtar si: Motrat Qiriazhi, K. Luarasi, J. Bageri, J. Vreto, K. Dako, A. Xhuvani, S. Shuteriqi etj. Këta emra të njohur mund të themi se janë edhe themeluesit e shkollës së hartimit të teksteve shkollore në Shqipëri. Duke qenë se shumica e tyre ishin marrë prej kohësh me hartimin e teksteve për nivele të ndryshme nxënësish, kishin krijuar në këtë mënyrë një përvojë të mirë, për të marrë përsipër të bëheshin zyrtarisht autorë të librave shkollorë. Krahas kësaj pune, vazhdonin me intensitet përpjekjet për hapjen e sa më shumë shkollave. Për të dhënë një shembull pozitiv në këtë drejtim, Vlora mori disa iniciativa të udhëhequra nga personalitete të njohura të këtij qyteti. Pas përgatitjeve të cilat kishin filluar më herët, u arrit që në fillimin e dhjetorit të vitit 1912 në qytetin e Vlorës të riçelej një shkollë shqipe. Për t’i dhënë prestigjin e duhur kësaj shkolle,

drejtimi iu besua veprimtarit të njohur të arsimit kombëtar dhe firmëtarit të aktit të Shpalljes së Pavarësisë, Jani Minga. Hapja e kësaj shkolle ishte premtuese, pasi që në fillim u regjistruan rreth 100 nxënës. Ndërkaq, edhe në trevat e tjera të kontrolluara nga qeveria e Vlorës u hapën disa shkolla tërësisht në gjuhën shqipe, siç ishin: dy në Elbasan dhe nga një në Berat, Lushnjë, Kavajë, Shijak, Krujë e Durrës. Një tjetër objektiv i guximshëm për qeverinë ka qenë hapja e shkollave për femrat. Femra në Shqipëri, si në të gjitha vendet e tjera myslimane, jo vetëm që e kishte të pamundur pjesëmarrjen në aktivitete shoqërore, por edhe arsimin e saj. Në përgjithësi, shumica e femrave ishin analfabete. Në fakt, gati në të njëjtin raport ishin edhe meshkujt, porse këta të fundit kishin privilegjin që të ishin më të pranishëm në jetën sociale, gjë që femra nuk e kishte. Mirëpo siç dihet, nëna është quajtur si mësuesja e parë e fëmijëve dhe nga shkalla e edukimit që ajo kishte, do të varej në një masë të madhe edhe edukimi i fëmijëve të saj. Në shoqërinë shqiptare të asaj kohe ishte e vështirë të flisje për një emancipim të shpejtë të femrës shqiptare. Shembullin e parë për këtë e kishte dhënë kleriku i nderuar I. Dalliu. Vetëm hapja e shkollës femërore në Korçë ishte e pamjaftueshme për arsimin e femrave në të gjithë vendin. Çelja e shkollave femërore, ndonëse ishte më e pranueshme për popullsinë e dy besimeve të tjera (katolikët dhe ortodoksët), kishin edhe ata disa kushte. Kleri katolik e pranonte shkollimin e femrave, por ishte kundër shkollave të përziera (djem e vajza).

Patriotët shqiptarë e kishin kuptuar shumë mirë se pa shkollimin e femrave, lufta e tyre për arsimin e shqiptarëve do të ishte gjysmake. Pas fitores së revolucionit xhonturk, shtypi shqiptar filloi të nxisë shkollimin e femrave, duke nxjerrë në pah vlerat e vajzave dhe grave shqiptare. *“Mendja e gruas shqipëtare mbeti virgjërisht edhe kthjelltësisht shqiptare. E mbyllur ndër Shqipëri dhe e palarguars’andejmi rruajti me kujdes ato që patmë për të ruajtur. Shqipëtarat, pra, janë një fushë e përgatitur për të pritur arsimin kombëtar dhe mësonjëset shqiptarka do të jenë njëmijë herë më të zonjat dhe më të besës për barrën që do të marrin përsipër.”* Vënia e theksit tek të drejtat e femrave, ishte për shqiptarët një mundësi që të veçoheshin si një popull që nuk kishte ndërmend të trashëgonte një traditë konservatore në këtë drejtim. Përkundrazi, ata kërkonin t’i jepnin femrës vendin që i takonte në shoqëri, si të gjithë kombet e përparuara. Femrave shqiptare u bëhet thirrje jo vetëm të merrnin dije, por edhe të jepnin dituri. Me fillimin e jetës së shteti të ri shqiptar, kërkohej një rol më aktiv i femrës, që do ta bënte shoqërinë shqiptare më të paqte e më të qytetëruar. *“Ç’i duhet këndimi vajzës?-ndihet për ditë kah thonë shumë në vend tonë.- Kjo të shkojnë e të xanë pëlhurë, të bajnë punët e shpis, të ven njat çarçaf në krye e të mshehet, ç’ duhen ksaj letrat e shkrimet?”* Shembulli i emancipimit të gruas shqiptare janë padyshim motrat Parashqevi dhe Sevasti Qizriazi. Ishin ato që kishin bëri hapin e parë për shkollimin e femrave me hapjen e shkollës që në vitin 1891. Shkolla u njoh me emrin “shkolla e vashave” dhe ishte i pari institucion shkollor laik për femrat. Qeveria e Vlorës nuk e la jashtë vëmendjes hapjen e institucioneve shtetërore për shkollimin e femrave. Shkolla e parë fillore femërore shtetërore u çel në vitin shkollor 1913-1914, në qytetin e Lushnjës, me një kapacitet prej 30 nxënësesh. Pavarësisht këtij numri të kufizuar të shkollave femërore, duhet thënë se ‘akulli ishte çarë’. Shkollat nuk ishin vetëm për djemtë, por edhe për vajzat. Nuk ishte vetëm Korça qyteti ku mund të shkolloheshin vajzat, por edhe Lushnja, Tirana dhe Shkodra. Raportimet e dhëna në atë periudhë flasin për një interesim jo të pakët, në drejtim të hapjes dhe mbarëvajtjes së shkollave të femrave. Në rubrikën ku bëhet fjalë për arsimin në Fier, korrespondenti i “Përlindjes”, shkruan se *“Fieri ka qytetëse djemsh dhe një fillore çupash. Libofsha ka një qytetare djemsh dhe tre mësues.”* Ndërkaq, në Durrës gjithçka ishte gati, por mungonte personeli mësues. Për këtë qëllim drejtorja arsimore

e kësaj prefekturë nxjerr një lajmërim (*zadhane*, siç thuhej në atë kohë), me qëllim fillimin sa më shpejt të shkollës edhe për femrat në këtë qytet. *“Kërkojmë për shkollën e çupave të Durrësit një drejtoreshë dhe dy mësuese të cilat duhet të dijnë të shkruajnë e të këndojnë gjuhën shqip. Drejtoresha lypset të ketë qenë më parë mësuese ku do në ndonjë shkollë.”* Femra në shkollë, do të ishte në të mirë të qytetit, familjes dhe shoqërisë. Gjithsesi, nuk hezitohet të shprehemi se në ato kushte që ndodhej Shqipëria më shumë se kaq nuk mund të bëhej. Hapja e këtyre shkollave i parapriu hapjes së shkollave pas Luftës së Parë Botërore, të cilat u bënë vatra të edukimit qytetar, atdhetar dhe luftës për liri të femrës shqiptare. Siç kishte ndodhur edhe më parë, çështja e fondeve për hapjen e shkollave shqipe u konsiderua jo vetëm si detyrë e shtetit, por edhe gjithë atyre që kishin mundësi të ndihmonin. Me mundësitë që iu paraqitën, ata kërkuan të bëjnë të pamundurën për të ndihmuar në hapjen e sa më shumë shkollave. Një tjetër problem me të cilin hasi qeveria e Vlorës ishte kundërshtimi që gjeti vendimi i saj për shpalljen e gjuhës zyrtare nga komunitetet fetare. Në mënyrë të veçantë, klerikët grekë e kundërshtuan këtë vendim, duke bërë të pamundurën që të mbanin privilegjet e dikurshme.

Patriarkana ende ëndërronte kohën e privilegjeve të dhëna nga Porta e Lartë dhe e kishte të vështirë që të vihej nën varësinë e shtetit të ri shqiptar. Si fillim, përfaqësuesit fetarë grekë kërkuan të gjejnë gjuhën e përbashkët me qeverinë e Vlorës. Për këtë qëllim peshkopi Jakov pati me Ministrin e Brendshëm të qeverisë së Vlorës Myfit Bej Libohovën, lidhur me çështjen e sipërpërmendur, ai mes të tjerash shkruan: *“Unë i thashë se “të shpresojmë shkëlqesi që të rruhen privilegjet e patriarkanës tonë. Patriarkana u përgjigj ai (Mufit Beu) dhe mitropolitë duhet të kufizohen në detyrimet e tyre fetare. Duhet tanimë të pushojnë këto propaganda. Edhe Syrja Bej Vlora i cili arriti këtu në një promemorje botuar në gazeta evropiane thekson “shpallet drejtësia e përgjithshme qytetare dhe të suprimohen menjëherë pretendimet e gjithë udhëheqësve fetarë.”* Qeveria e Vlorës vazhdonte të tregojë e prerë në çështjen e arsimit, duke ligjësuar faktin se gjuha zyrtare ishte ajo shqipe dhe se në të gjitha shkollat tashmë mësimi do të bëhej në gjuhën amtare. Në fakt, kjo masë indirekt hiqte mësimin në gjuhë të huaj në shkollat shqiptare, duke i dhënë rendësi vetëm gjuhës dhe arsimit kombëtar. Pasi nuk u morën vesh në mënyrë të drejtpërdrejtë me qeverinë, Patriarkana mendoi se në Komisionin Ndërkombëtar do të gjenin më shumë mirëkuptim kërkesat e tyre. *“Problemin e shkollave të huaja, Komisioni e shqyrtoi në seancat 59 e 65 të mbledhjeve të tij. Në Komision u thirr edhe L. Gurakuqi. Delegati rus Petrajef e vinte rihapjen e shkollave ortodokse si parakusht për rivendosjen e paqes në tokat që do të zbrazeshin nga ushtritë e huaja.”* Pas bisedimesh jo pa tensione, Komisioni doli me një formulë kompromisi, që dukshëm anonte më shumë nga interesat shqiptare. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit vendosi që mund të hapeshin shkollat shqiptare ortodokse, por *“Mësimi i parë të jetë shqipja dhe mësuesit të mos jenë nga kombësitë e huaja.”*

Këto fakte, ndonëse në pamje të parë, nuk mund të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me politikën arsimore të Qeverisë së Vlorës, flasin fare qartë se udhëzimi i qeverisë që të gjitha shkollat të jenë nën kontroll të qeverisë dhe të zbatohen të njëjtin program kombëtar, nuk u ndryshua dot as nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ndonëse Komisioni tentoi t’u largohet fakteve reale dhe të rikthente në Shqipëri rregullat e vjetra të Perandorisë Osmane, argumentet e drejtorit të arsimit Gurakuqi, bindën më në fund anëtarët e Fuqive të Mëdha të rikthejnë shkollat në binarët kombëtar të vendosur nga qeveria e Qemalit. Pikërisht kjo është një tjetër meritë dhe rezultat i punës së qeverisë së Vlorës, e cila, edhe pse nuk ishte më formalisht, programi saj për një shkollë kombëtare kishte dhënë rezultatet e parë të një politike afatgjatë. Kjo për faktin se direkt apo indirekt, KNK e kishte miratuar atë program, duke mos e ndryshuar edhe për hir të balancave politike në Ballkan.

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve, arritjet e qeverisë së Vlorës, në një hark afërsisht prej 26 muajsh, kanë qenë pak më shumë se modeste. Faktorët e mungesës së një suksesi të gjerë në këtë drejtim kanë qenë të shumtë. Një nga faktorët më kushtëzues ka qenë ai politik. Shqipëria fitoi pavarësinë e saj, por në një territor që qeveria e Vlorës nuk e kontrolloj, asnjëherë plotësisht. Vendi u pushtua nga trupat e vendeve fqinje, të cilat, nuk lejuan për asnjë moment të kishte një rritje të autoritet të qeverisë së Vlorës. Në arenën ndërkombëtare, refuzimi i vendeve më me peshë të Evropës për të njohur qeverinë, ka ndikuar po kaq negativisht. Entuziazmi i ditëve të para u kthye në një trishtim për mundësitë e pakta të mbijetesës së shtetit të ri. Problemet që ishin vërejtur më parë, u acaruan edhe më shumë. Arsimi ndër të gjithë ishte më i vështiri për t'u vënë nën kontroll. Kishte një tërësi mungesash nga stafi mësimdhënës tek infrastruktura shkollore (së bashku me atë rrugore), tekste, programet e me radhë. E megjithatë, përpos gjithë vështirësi, qeveria guxoi të tregonte një vullnet dhe program të qartë. Kjo tregon edhe një herë një largpamësi të saj, pjekuri në ditë të vështira dhe racionalitet në mënyrën e arsyetimit të problemeve të vendit.

A ishte programi qeveritar i arsimit më i miri? Ai përmbushte ai interesat e vendit. E vështirë të gjykosh në këto ditë pa provuar situatën e atëhershme që po kalonte qeveria. E vërteta është se ai ishte program realist, ambicioz dhe më i duhuri për kohën që kalonte vendi. A u justifikuan masat e marra nga qeveria me rezultate në terren? Në një artikull të saj kohe mes të tjerash vërehej se: *“Megjithë mundimet dhe përpjekjet e Z. L. Gurakuqi, i cili në çastin e lindjes së shtetit shqiptar gjendet në krye të arsimit, sa shkolla janë hapur, sa punojnë mirë. Por sot për sot duhet të kënaqemi dhe me kaq. Numri i shkollave do të shtohet, numri i atyre që do t'i jepen kësaj mjeshtrie atdhesore, do të shtohet.”* Kjo është një nga ato analizat, e cila vë në peshë atë që ne dëshirojmë të bëjmë me atë sa është bërë, duke marrë në konsideratë kushtet në të cilat kemi qenë. Ka pasur kritika të drejta për punën e qeverisë. Një nga këto ka qenë për përdorimin e gjuhës shqipe. Shqiptarët ishin përpjekur për gjuhën e tyre, ndoshta më shumë se çdo komb dhe popull tjetër në Ballkan e Evropë. Por kur kjo mundësi u dha, gjendeshin ende mes tyre shumë që nuk flisnin gjuhën shqipe, por preferonin ende të përdornin gjuhët e huaja. Në këtë këndvështrim ishte i patolerueshëm fenomeni i vërejtur i mospërdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare nga një pjesë e administratës së shtetit, e cila e kishte detyrimin më të parë përdorimin e gjuhës amtare. Kjo nuk ishte e denjë për shtetin e ri shqiptar dhe natyrisht nuk u linte një shije të mirë edhe të huajve në Shqipëri. Ata mund të habiteshin me një kundërshti në atë që vërenin dhe atë që kishin dëgjuar më parë për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Ndërsa përdorimi i gjuhës shqipe u vendos si një nga kërkesat më të para, në peticionet e shumta dërguar Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha, tani që ajo kishte fituar lirinë e saj, prapë mbetej e përdorur pak. Kjo kishte shqetësuar jo pak edhe opinionin elitar shqiptar. *Ndërment, që Shqipëria do të bëhej një shtet më vehte duk më patur gjuhë zyrtare shqipen, gjuhën e saj.”*

Përfundime

Në një analizë përfundimtare, arritjet e qeverisë së Vlorës në fushën e arsimit kombëtar, sikundër thamë, duhen gjykuar nga situata politike, mundësitë financiare, si dhe trashëgimia e arsimit në Shqipëri. Po të gjykosh mbi situatën politike, gjithsecili bie dakord se ajo nuk linte hapësira të shumta veprimi për cilëndo qeveri që kërkon të zbatojë vizionin e vet për politikën arsimore. Arsimi është një sektor që rritet ngadalë, me hapa të kujdesshëm. Që të rritet i shëndetshëm, arsimi kërkon një mbështetje të mirë financiare, që është një nga kushtet më themelore për suksesin e tij. Suksesi garantohej nga infrastruktura shkollore, mësimdhënia cilësore, programe të mira dhe së fundi,

tekste të përshtatshme për të gjitha grup moshat. Të garantoje të gjitha këto në aq pak kohë që pati qeveria e Vlorës, është thujse mision i pamundur për cilëndo qeveri edhe në ditët tona. Nuk duhet të harrojmë se vendi kishte një trashëgimi nga më mjeranet të lëna nga osmanët në Shqipëri. Në vend sundonin shkollat e ulëta, shumë pak qytetëse, dhe akoma më pak të mesme. Në shumë zona rurale thujse nuk ekzistonin ndërtesa shkollore. Shumat që kërkoheshin për ngritjen e tyre i tejkalon çdo mundësi financiare për shtetin e atëhershëm shqiptar. Kjo vështirësi e madhe vinte edhe si shkak i infrastrukturës mjaft të dobët shkollore të trashëguar nga shteti osman. Ndonëse të gjitha shkollat ishin në gjuhë të huaj (më të shumta turke), shteti osman nuk siguroi asnjëherë në të gjithë territorin të drejtën për shkollim. Sikundër e sqaruam edhe më lart, nuk kishte vend për shkollat shqipe, ndërkaq që shkollat e huaja jo-turke lulëzonin diku përmes presionit politik, e diku përmes ryshfetit të marrë nga qeveritarët osmanë. Shteti osman investoi shumë pak në infrastrukturën shkollore e shumë më tepër në propagandën që edhe ato pak shkolla që ishin, duhet të frekuentoheshin vetëm nga meshkujt. Veç faktit që shkolla bëhej më pak sociale, ajo ishte në kundërshtim me prirjen e shqiptarëve për një arsim të barabartë mes femrave dhe meshkujve. Kjo ishte një patjetër sfidë të cilën qeveria e pa në sy dhe kërkoi të japi sinjale pozitive me hapjen e atyre pak shkollave femërore në qytete të rëndësishme. Hapja e këtyre institucioneve të arsimit femëror, në numër dhe pjesëmarrje të paktë, e cila shënonte të parën iniciativë shtetërore për arsimin e femrave në Shqipëri, natyrisht që është arritje për kohën, edhe pse modeste në shtrirjen e saj gjeografike. Më së fundi, miti i shkollimit dhe hegjemonisë së meshkujve në të gjithë jetën e vendit, kishte pësuar një krisje, që më pas do të merret më shumë të çara me modernizmin e shteti shqiptar. Shteti shqiptar u përpoq të përcillte ide dhe vizon bashkëkohor për arsimin, por kushtet në të cilat veproi ai lejuan shumë pak zbatimin në terren. Gjithsesi, nuk mund të gjykohej asnjëherë as vullneti i mirë dhe as dëshira që qeveria kërkonte ta shikonte Shqipërinë me më shumë shkolla në të gjithë vendin. Tani në ato pak shkolla që u hapën dhe ato që do të hapeshin më vonë, fëmijët shqiptarë kishin shansin të mësonin në gjuhën e tyre. Ky konsiderohej një fat i madh që paraardhësve të tyre, nuk iu dha asnjëherë.

Referenca

1. Akademia e Shkencave (2004) Historia e Popullit Shqiptar
2. “Përlindja e Shqipëniës”, (Vlorë1914). Në Peshtan u hap një shkollë
3. Komuniteti Mysliman Shqiptar (2012). Enciklopedi: 100 personalitetet shqiptare të kulturës islame.
4. Komuniteti Mysliman Shqiptar (2012). Enciklopedi: 100 personalitetet shqiptare të kulturës islame.
5. Akademia e Shkencave (2004) Historia e Popullit Shqiptar
6. “Përlindja e Shqipëniës”, (Vlorë: Nr. 13, 14 shtator 1913).
7. Hoti.V.(, 2002) Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar
8. Hoti.V.(, 2002) Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar
9. Kanini. I. (2001) Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së I Botërore
10. Dielli (Boston1909). Për arsimin e femrave
11. Bashkimi”, (Shkodër:1910). T’rritunin e varzavet.
12. “Përlindja e Shqipëniës” (1913). Gjendja arsimore e vashave
13. “Përlindja e Shqipëniës” (1913). Zadhanie
14. AQSH, Kutia 3, Dosja 18, Patriarkut Ekumenik Germanos Fanar, 15.09.1913
15. Arben Puto (2003). *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*
16. Përlindja e Shqipëniës, (Vlorë: 1914). Shkollat e vogla
17. *Përlindja e Shqipëniës*, (Vlorë: 1914) Shkollat e vogla